REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Byroja

V E N D I M

Nr.9, datë 24.5 .2010

PËR DHËNJEN E MASËS DISIPLINORE NDAJ DEPUTETIT TOM DOSHI

Në mbështetje të nenit 11, pika 5 dhe 65, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Byroja e Kuvendit, në mbledhjen e datës 24.5.2010, pas verifikimit të regjistrimeve audiovizive dhe transkripteve të tyre, pas paralajmërimit tre herë të drejtueses së seancës plenare ndaj deputetëit Tom Doshi, për përdorim të fjalëve fyese, shkaktimit të rrëmujës në seancën plenare të datës 24.5.2010 dhe tentativës për përdorimin e dhunës, me propozim të 7 deputetëve,

V E N D O S I:

I. Deputeti Tom Doshi, për përdorim të fjalëve fyese, provokim të rrëmujës në seancë plenare që pengon zhvillimin e saj dhe tentativë për përdorimin e dhunës, përjashtohet nga pjesëmarrja në punimet e komisioneve të Kuvendit dhe seancës plenare për një periudhë 15 ditore.

II. Masa disiplinore shoqërohet me sanskionin financiar të ndalimit të pagës për 15 ditë.

III. Ngarkohet Shërbimi i Sigurisë dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI